



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**  
**Nr. 285, datë 08.09.2020**

**PËR**  
**VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATI Z. {...}**  
**TË TRE KRITEREVE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË**  
**GJYKATËN E APELIT TIRANË PËR DY POZICIONE TË LIRA NË FUSHËN E TË**  
**DREJTËS PENALE, TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 184 DHE NR. 185, DATË**  
**28.05.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE VIJIMIN E PROCEDURËS**  
**SË VERIFIKIMIT PËR KRITERET E TJERA LIGJORE TË KANDIDIMIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, si dhe në pikën 9, të Vendimeve të tij nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, “Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori i saj, z. Alban Toro,

**VENDOSI:**

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës penale me Vendimet nr. 184, nr.185 datë 28.05.2020.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**